



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0126

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahim-Kryesuese, Vedat Poterqoi dhe Kimete Gashi-Brajshori-Anëtar të Panelit Shqyrtues duke vendosur sipas ankesës së OE LURN SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ri-adaptimet e hapësirave në ndërtesat qeveritare” me numër të prokurimit 214-25-3033-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Punëve të Brendshme., më 20.04.2026, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërishte e bazuar ankesa e LURN SH.P.K. me nr. 2026/0126, e datës 02.03.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ri-adaptimet e hapësirave në ndërtesat qeveritare”, me numër të prokurimit 214-25-3033-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – Ministria e Punëve të Brendshme.
2. Mbetet në fuqi, B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - Ministria e Punëve të Brendshme., për aktivitetin e prokurimit “Ri-adaptimet e hapësirave në ndërtesat qeveritare”, me numër të prokurimit 214-25-3033-5-1-1.
3. Në përputhje me nenin 31 pika 4 dhe 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 05.05.2025 Ministria e punëve të brendshme., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit “Ri-adaptimet e hapësirave ne ndertesat qeveritare” me nr. të prokurimit: "214-25-3033-5-1-1".

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 750,000.00 €.

Me 10.02.2026 Ministria e punëve të brendshme., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), ku është rekomanduar për kontratë OE “NNP “Hexagon Construction” Sh.p.k.

Me 16.02.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 24.02.2026 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 02.03.2026, OE INFINITT SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokoll 2026/0126, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për dhënie të kontratës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues INFINITT SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Ne, si operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, paraqesim ankesë formale kundër Njoftimit për Dhënie të Kontratës në favor të operatorëve ekonomikë “Hexagon Construction sh.p.k.” & “Eing sh.p.k.”, për shkak se vendimi është marrë në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës (LPP) dhe parimet themelore të tij, në veçanti:

parimin e trajtimit të barabartë dhe jodiskriminimit të operatorëve ekonomikë;

parimin e konkurrencës së ndershme;

parimin e efikasitetit dhe ekonomicitetit në shpenzimin e fondeve publike;

detyrimin për vlerësim objektiv dhe verifikim të ofertave.

1. Shkelje thelbësore në vlerësimin e ofertës fituese

Oferta e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues përmban çmime dukshëm dhe në mënyrë të pajustificueshme më të larta se çmimet reale të tregut në Kosovë, përkatësisht çmime jo reale në paramasë. Në shumë pozicione, çmimet janë deri në dhjetëfish më të larta krahasuar me çmimet reale të tregut në Kosovë. Këto çmime bien ndesh me parimin e vlerësimit ekonomikisht më të

favorshëm dhe dëmtojnë drejtpërdrejt buxhetin publik. Sipas vlerësimit tonë paraprak, dëmi i mundshëm financiar tejkalon 500,000.00 €.

Ky disproportion i theksuar ndërmjet çmimeve të ofruara dhe çmimeve reale të furnizimit përbën rrezik serioz për dëmtim të buxhetit publik. Për këtë arsye, do të bashkëngjisim paramasën e plotë të OE fitues për verifikim të detajuar.

2. Shembuj konkretë të çmimeve të ofertuara

A5 – Demolimi i laminatit (1 m²)

Çmimi i ofertuar: 10.00 €/m².

Çmimi real i tregut në Kosovë është rreth 1.00 €/m². Ky çmim është rreth dhjetëfish më i lartë dhe paraqet kosto të pajustificueshme për buxhetin publik.

A7 – Demolimi i dyerve (1 derë)

Çmimi i ofertuar: 50.00 €/derë.

Çmimi real i tregut është rreth 10–15 €. Ky çmim paraqet mbifaturim të pajustificueshëm.

A19 – Demolimi i tepisonit në zyra

Çmimi i ofertuar: 12.25 €/m².

Çmimi real i tregut është rreth 1.50–2.00 €/m². Çmimi është shumëfish më i lartë se realiteti i tregut.

A20 – Furnizimi dhe montimi i tepihut për dysheme teknike 50x50

Çmimi i ofertuar: 40.00 €/m².

Çmimi real i tregut për furnizim dhe montim është rreth 15–20 €/m². Diferenca është e pajustificueshme dhe e dëmshme për fondet publike.

A28 – Furnizimi dhe vendosja e llajsneve të laminatit

Çmimi i ofertuar: 10.00 €/m.

Çmimi real i tregut për material është rreth 0.50 €/m, ndërsa me montim nuk e tejkalon 2.00 €/m.

A29 – Montimi i plafonit të lëshuar Armstrong

Çmimi i ofertuar: 40.00 €/m².

Çmimi real: materiali rreth 6.00 €/m² dhe montimi maksimalisht 4.00 €/m² (gjithsej rreth 10.00 €/m²). Oferta paraqet rritje katërfish pa justifikim teknik.

A32 – Suvatimi (1 m²)

Çmimi i ofertuar: 20.00 €/m².

Çmimi real: materiali rreth 2.00 €/m² dhe puna rreth 3.00 €/m² (gjithsej rreth 5.00 €/m²).

A33 – Gletimi dhe ngjyrosja

Çmimi i ofertuar: 10.00 €/m².

Çmimi real i tregut: rreth 3.00–4.00 €/m².

A34 – Vetëm ngjyrosja

Çmimi i ofertuar: 10.00 €/m².

Çmimi real: 3.00–5.00 €/m². Duke pasur parasysh sipërfaqen e madhe për ngjyrosje, ky çmim i fryrë krijon dëm të konsiderueshëm në buxhetin e Republikës së Kosovës.

A35 – Ndarje të brendshme alumini termik me xham të lameluar 4-10-4

Çmimi i ofertuar: 225.00 €/m².

Çmimi real maksimal në treg është rreth 100.00 €/m², edhe duke përfshirë fitim të lartë për operatorin ekonomik.

A37 – Vendosja e dyerve të drurit

Dera 90x210 cm: 650.00 €, ndërsa dyert me dimensione më të mëdha janë ofertuar më lirë (425 € dhe 500 €), gjë që paraqet mospërputhje logjike dhe ekonomike. Çmimi real maksimal për një derë cilësore është rreth 300.00 €.

A38 – Vendosja e dyerve plastike

Dera 90x210 cm: 255.00 €, ndërsa dyert më të mëdha janë ofertuar me 150.00 €, çka paraqet mospërputhje të paarsyeshme ekonomike.

B52 – Demontimi i aparatit klimatizues (12–24 BTU)

Çmimi i ofertuar: 200.00 € / njësi.

B53 – Montimi i aparatit klimatizues (pa furnizim)

Çmimi i ofertuar: 200.00 € / njësi.

Totali: 400.00 € për demontim dhe montim, ndërsa çmimi real maksimal është rreth 80–90 €.

C1 – Kabllo energjetike PPY 3x1.5 mm

Çmimi i ofertuar: 5.05 €/m.

Çmimi real: rreth 0.40 €/m për material dhe rreth 1.00 €/m me montim.

C8 – Kuti për priza PVC 4M

Çmimi i ofertuar: 10.95 €.

Çmimi real me montim: rreth 1.00 €.

C9 – Kuti për priza PVC 7M

Çmimi i ofertuar: 11.05 €.

Çmimi real me montim: rreth 1.30 €.

C13 – Kanale PVC 16x16x2000 me ngjitës

Çmimi i ofertuar: 12.00 € / 2 m.

Çmimi real: rreth 1.00 € / 2 m. Pozicionet C13–C18 janë në mënyrë të vazhdueshme të dhjetëfishuara.

Gjithashtu, të gjitha pozicionet e kabllave janë ofertuar me çmim uniform 5.05 €/m, çka nuk reflekton realitetin e tregut dhe paraqet mbifaturim të qëllimshëm. Pozicionet C17–C26 janë në përgjithësi të fryra; për shembull, C17 – prizë energjetike 230V komplet me aksesori 2M është ofertuar 9.20 €, ndërsa çmimi real me montim është rreth 3.00 €. Po ashtu, vërehet rritje trefishe e pajustificueshme e çmimeve për trupat ndriçues pa arsyetim teknik apo ekonomik.

Duke u bazuar në faktet dhe dëshmitë e paraqitura, vlerësojmë se vendimi për dhënie të kontratës është marrë në kundërshtim me parimet themelore dhe dispozitat e LPP-së, duke cenuar trajtimin e barabartë, konkurrencën e ndershme dhe ekonomicitetin në shpenzimin e fondeve publike.

Çmimet e larta dhe joreale të ofertës fituese përbëjnë rrezik serioz për dëmtim të buxhetit publik dhe tregojnë mungesë verifikimi të duhur nga Autoriteti Kontraktues. Konsiderojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së, pasi është rekomanduar për kontratë një operator ekonomik që nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Po ashtu, nuk është respektuar neni 7 i LPP-së, pasi është favorizuar operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, ndërsa ne jemi diskriminuar edhe pse kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së përcakton se Autoriteti Kontraktues duhet t'i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe të veprojë në mënyrë transparente, ndërsa paragrafi 6 i këtij neni parasheh se tenderi i zgjedhur duhet të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse, gjë që në këtë rast nuk është respektuar.

Gjithashtu, nuk është marrë në konsideratë as neni 1 i LPP-së, i cili synon të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike nga autoritetet kontraktuese në Republikën e Kosovës.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Lidhur me pretendimet për shkeljen e neneve dhe pikat ankimore të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim nga OE, Autoriteti Kontraktues – Ministria e Punëve të Brendshme konstaton se ka vepruar në përputhje të plotë me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP), përkatësisht me: nenin 1 (Qëllimi), nenin 6 (Ekonomiciteti dhe efikasiteti), nenin 7 (Barazia në trajtim dhe jo-diskriminimi), nenin 59 (Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve), nenin 72 (Dokumentacioni dhe informacioni shtesë), si dhe nenin 40 të Rregullores Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik. Po ashtu, AK ka vepruar në harmoni me nenin 60 të LPP-së (Kriteret për

dhënien e kontratës) dhe nenin 41 të Rregullores Nr. 002/2024 (Tenderët jo-normalisht të ulët), në përputhje me kriteret e vendosura në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit, duke trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Kriteri për dhënie të kontratës ka qenë “oferta e përgjegjshme me çmimin më të ulët”, mbi bazën e të cilit AK ka siguruar trajtim të barabartë dhe pa diskriminim për të gjithë OE-të në këtë aktivitet prokurimi.

Ministria e Punëve të Brendshme – ZPP, pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, ka shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore, tenderuesit OE “LURN” SH.P.K., Prishtinë. Pas analizimit të pretendimeve kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK të publikuar më 10.02.2026, konstatohet se AK i ka trajtuar në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim të gjithë tenderuesit, në përputhje me LPP-në, vendimet e OSHP nr. 2025/0895 dhe 2025/0904, si dhe aktet tjera nënligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

Përgjigje në pretendimin ankimor nr. 1

Pretendimi i OE “LURN” SH.P.K. lidhur me çmimet e ofertës së Grupit të OE të rekomanduar për kontratë HEXAGON CONSTRUCTION SH.P.K. & EING COM SH.P.K. nuk qëndron.

Çmimet e ofertës së rekomanduar reflektojnë realitetin aktual të tregut, i cili po përballët me rritje të vazhdueshme të çmimeve. Për më tepër, në bazë të nenit 27.15 të Rregullores Nr. 002/2024 (ndryshimi i Rregullores Nr. 001/2022), nuk lejohet krahasimi i çmimeve të ofertave ndërmjet tyre për konvertim në pikë dhe peshim, pasi një metodë e tillë nuk garanton domosdoshmërisht rezultatin me çmimin më të ulët.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vendimeve të OSHP, konstatohet se komisioni i rivlerësimit ka kryer vlerësimin dhe rekomandimin për dhënien e kontratës në përputhje me kriterin e Dosjes së Tenderit: “tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët me peshim”.

Prandaj, ky pretendim refuzohet si i pabazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor nr. 2

Komisioni për ekzaminim, vlerësim dhe krahasim të tenderëve ka vepruar në përputhje me nenin 59 dhe 72 të LPP-së dhe nenin 41 të Rregullores Nr. 002/2024 për tenderët jo-normalisht të ulët. Përmes letrës standarde B41 është kërkuar nga OE ankues një analizë financiare e detajuar për arsyetimin e çmimit të ofruar, duke qenë se oferta rezultonte jo-normalisht e ulët për shumicën e pozicioneve (A1, A3, A14–A18, A30–A32, B1–B7, B32, 37–39, 43, 44, 49–53, etj.).

OE ka dorëzuar përgjigje më 19.08.2025, por nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme për të arsyetuar çmimin. Në përputhje me nenin 61 të LPP-së dhe nenin 41.10 të Rregullores Nr. 002/2024, AK ka shqyrtuar elementet përbërëse të ofertës (ekonominë e shërbimeve, zgjidhjet teknike, kushtet e favorshme dhe origjinalitetin e furnizimeve) dhe ka konstatuar se oferta është jo-normalisht e ulët dhe rrjedhimisht jo e përgjegjshme, duke u refuzuar në përputhje me vendimin e OSHP nr. 2025/0904.

Në pajtim me nenin 61 paragrafi 5 të LPP-së, më 11.02.2026 është njoftuar edhe KRPP për ofertën jo-normalisht të ulët përmes formularit standard B51.

Prandaj, ky pretendim refuzohet si i pabazuar.

Konkluzion

Në bazë të Ligjit për Prokurimin Publik dhe nenit 108/A (Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve), Ministria e Punëve të Brendshme nxjerr këtë:

Vendim

I. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e OE “LURN” SH.P.K. kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK të publikuar më 10.02.2026 për aktivitetin e prokurimit “Riadaptimi i hapësirave në ndërtesat qeveritare”, nr. prokurimit 214-25-3033-5-1-1.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e AK i publikuar më 10.02.2026 nga Ministria e Punëve të Brendshme.

III. Autoriteti Kontraktues, bazuar në provat e paraqitura, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me date 02.03.2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0126, ndërsa me datë 11.03.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0126, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është përgjigjur rreth rekomandimit të raportit të ekspertit shqyrtues, po ashtu as OE nuk është përgjigjur lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE LURN SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0126 ka vlerësuar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues – Ministria e Punëve të Brendshme, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, kontratë publike kornizë-punë. Vlera e parashikuar 750,000.00€. Kriteret e Dhënies së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët.

Sqarim hyrës: Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku kjo procedurë e prokurimit ka qenë objekt i shqyrtimit në OSHP, ndërsa ekspertja shqyrtuese ka nxjerr raport të ekspertizës me Nr.0895/2025, dhe Nr.0904/2025, të datës 29.09.2025. Po ashtu, Paneli Shqyrtues ka gjykuar me Vendimin PSH.nr.0895-0904/2025, të datës 09.12.2025, duke e aprovuar si pjesërisht të bazuar ankesën e OE “Lurn” Sh.p.k.-Prishtinë, kurse ka anuluar

njoftimin mbi vendimin e AK-së B58, dhe lëndën e ka kthyer në rivlerësim.

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, sqarojmë se operatori ekonomik ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 60, dhe 61, të LPP-së. Pretendimet e ngritura ankimore nga ana e operatorit ekonomik ankues janë shqyrtuar nga ekspertja duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe jep përgjigje si në vijim.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se pretendimi ankimor lidhur me arsyetimin e eliminimit të Operatorit Ekonomik ankues është trajtuar në raportin paraprak me nr. 0904/2025, të datës 29.09.2025, andaj bazuar në nenin 16 paragrafi 2 dhe 3 të Rregullores nr. 01/2020 për Punën e Organit Shqyrtues të Prokurimit, ky pretendim konsiderohet çështje e gjykuar (“res judicata”).

Operatori ankues pretendon se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka ofertuar çmime të shumëfishuara në raport me çmimet reale të tregut në Republikën e Kosovës. Ky pretendim lidhet me pozicionet: A5, A7, A19, A20, A28, A29, A32, A33, A34, A35, A37, A38, B52, B53, C8, C9, C13 dhe C17–C26, për të cilat OE ankuesi pretendon se çmimet e ofruara nga operatori ekonomik i rekomanduar “Hexagon Construction” shpk, janë dukshëm më të larta se çmimet e tregut.

Sa i përket pretendimeve lidhur me nivelin e çmimeve të ofertës së operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë “Hexagon Construction” shpk, ekspertja shqyrtuese vlerëson se në përputhje me nenin 4 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, përkatësisht paragrafi 1 pika c, të plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren nr. 02/2024, Autoriteti Kontraktues obligohet të sigurojë që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut. Në mënyrë specifike, neni 4.1 pika c i kësaj rregulloreje përcakton detyrimin e Autoritetit Kontraktues që gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit të sigurohet se çmimi i kontratës është në përputhje me çmimet reale të tregut. “c. të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut”.

Bazuar në shkresat e lëndës, ekspertja shqyrtuese vlerëson se Autoriteti Kontraktues Ministria e Punëve të Brendshme, gjatë procesit të rivlerësimit ka vepruar në përputhje me Vendimin e Panelit Shqyrtues nr. 0895-0904/2025, të datës 09.12.2025.

Këtë vlerësim e bazoj nga shkresat e lëndës, konkretisht nga vendimi mbi kërkesën për rishqyrtim i datës 24.02.2026, pasi Autoriteti Kontraktues ka sqaruar se në përputhje me nenin 61 paragrafi 5 të Ligjit për Prokurim Publik, përmes dokumentit standard B51 Njoftim për Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik – më datë 11.02.2026 ka njoftuar Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ofertës Jo-Normalisht të Ulët në këtë procedurë prokurimi sipas Vendimit nr. 0895-0904/2025, të datës 09.12.2025.

Në mbështetje të asaj që u përshkrua si më lartë, vlerësimi ynë është se e procesi i vlerësimit të ofertave është bërë në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, përkatësisht në harmoni me nenin 59 dhe 61 të LPP-së, si dhe në pajtim me Vendimit PSH.nr.0895-0904/2025.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli

Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes duke lënë në fuqi vendimin e AK-se.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuar nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit dhe uke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e konstatimeve dhe rekomandimit në raportin e ekspertit shqyrtues që vendimi të mbetet në fuqi.

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues sikurse në vendimin paraprak **2025/0895 për çka është konstatuar se po i njejtë OE ankues** nuk ka ofruar dëshmi -prova dëshmi -prova bindëse as në Kërkesën për rishqyrtim dhe as në Ankesën e deponuar pran OSHP-së lidhur me çmimet e ofruara në ofertë , keshtu duke u thirrur se OE na ka eliminuar për çmime të ofruar si jo normalisht të ulëta , mirpo në këtë ankesë ka atakuar edhe OE-në e rekomanduar, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar për faktin se çmimet të cilat i ka kontestuar në ankesë për OE e rekomanduar lidhur me pozicionet sipas Udhëzuesit për Prokurim Publik kur kemi të bëjmë me kontrata publike-kornizë sipas poentimit sikurse në këtë procedur duhet të plotësohen kushtet pragu 30% i çmimit mesatar i tenderëve të përgjegjshëm, ku nga 06 ofertat e pranuar në këtë procedur OE ankues ka ofruar çmimin 449,74 i cili është eliminuar nga AK-ja për çmime jo-normalisht të ulëta , ndërsa OE i rekomanduar 8,745.20 dhe oferta e pa suksesshme me çmimin të ranguar prej 8,857.07 . Mirëpo PSH thekson se Autoriteti Kontraktues obligohet të sigurojë që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut. Po ashtu edhe OE ankues nuk ka ofruar ndonjë dëshmi-prove , ndonjë profatur etj.. lidhur me çmimet të tregut , mirëpo ka ofruar vetëm një përshkrim ku për PSH nuk mund të mirën si prove bindëse pa ofruar ndonjë fakt konkret kjo marrë parasysh edhe analizimin e pozicioneve të kontestuar me ofertat tjera pjesëmarrës, andaj në këtë rastë e aprovon si pjesërisht ankesën, por e pa mjaftueshme që lënda të kthehet në rivlerësim , bazuar në vendimin paraprak 2025/0895 si dhe në përshkrimin e lartë cituar ku OE ankues nuk mund të jetë pal me interes në kuptim të nenit 4 paragrafit 1.26 ku citohet Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar..

Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetet në fuqi B58''Njoftimi mbi Vendimin te Autoritetit'', lidhur me aktivitetin e prokurimit ''Ri-adaptimet e hapësirave ne ndertesat qeveritare'' me nr. të prokurimit: "214-25-3033-5-1-1".

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në diapozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- **OE - LURN SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: